



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:239457

Datë: 27.08.2024

Numri i dokumentit: 06090071

C. nr. 2023:239458

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**, si Gjykatë civile në shkallë të parë, gjyqtari Burhan Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Bega, duke vendosur në çështjen civile kontestimore të paditësit **Sh. (I.) L.** nga fshati ..., Kaçanik, i identifikuar me letërnjoftim numër personal ..., të lëshuar nga MPB në Prishtinë, kundër të paditurve **E. (M.) L.**, i identifikuar me numër personal ..., **I. (M.) L.**, i identifikuar me numër personal ..., **R. (M.) A.**, e lindur **L.**, e identifikuar me numër personal ..., **B. (I.) L.**, i identifikuar me numër personal ..., **Sh. (I.) J.**, e lindur **L.**, e identifikuar me numër personal ..., **L. (Ilmi) L.**, i identifikuar me numër personal ..., të gjithë nga fshati ..., Kaçanik, për çështjen kontestuese Vërtetimin e pronësisë, jashtë seance më dt. 27.08.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**  
(Në bazë të pohimit)

**I.APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit **Sh. (I.) L.** nga fshati ..., Kaçanik, në tërësi si e bazuar dhe **VËRTETOHET** se paditësi **Sh. (I.) L.** është pronarë i njësive kadastrale, edhe atë:

-Njësia kadastrale ..., e llojit parcelë, e tipi pronë private, me sipërfaqe 1645m<sup>2</sup>, në pjesëmarrje 1/1, e cila gjendet ne ZK. ..., Komuna Kaçanik,

- Njësia kadastrale ..., e llojit parcelë, e tipi pronë private, me sipërfaqe 1030m<sup>2</sup>, në pjesëmarrje 1/1, e cila gjendet ne ZK. ..., Komuna Kaçanik,

- Njësia kadastrale ..., e llojit parcelë, e tipi pronë private, me sipërfaqe 687m<sup>2</sup>, në pjesëmarrje 1/1, e cila gjendet ne ZK. ..., Komuna Kaçanik,

-Njësia kadastrale ..., e llojit parcelë, e tipi pronë private, me sipërfaqe 2546m<sup>2</sup>, në pjesëmarrje 1/1, e cila gjendet ne ZK. ..., Komuna Kaçanik,

**II.** Konstatohet se pala paditëse e ka paguar taksën gjyqësore në emër të taksës për padi në shumë prej 20€.

### **A r s y e t i m**

Paditësi më dt. 06.11.2023, në këtë Gjykatë ka ushtruar padi me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë dhe ka theksuar se pasuritë e paluajtshme evidentohen në emër të paraardhësit të të paditurve S. L. , duke theksuar se të paditurit janë trashëgimtarët të të ndjerit S. L. , ndërsa pasuritë objekt i kësaj padie janë në posedim të paditësit këto parcela janë blerë me marrëveshje verbale nga babi i paditësit ne vitin 1983, dhe menjëherë pas pagesës së shumës prej 1,000.00 marka nga blerësi, i njëjti ka hyrë në posedim dhe që nga ajo kohë nuk ka arritur të bëjë bartjen e këtyre parcelave, njëherit ka theksuar se të paditurit janë trashëgimtarët e vetëm të të ndjerit- fëmijët e dy djemve të të ndjerit S. L. , M. dhe I., të cilët kanë ndërruar jetë pa e bërë trashëgiminë, dhe të cilët nuk e kanë kundërshtuar asnjëherë këtë pjesë të pronësisë, prandaj ka kërkuar nga gjykata që të vërtetojë edhe në mënyrë formale ekzistimin e pronësisë në këtë pjesë të parcelave.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Të paditurit në përgjigje në padi më dt.12.03.2024, të ushtruar brenda afatit ligjor njëzëri kanë deklaruar se nuk e kundërshtojnë kërkesëpadinë e paditësit dhe shtojnë se është e vërtetë që këto parcela janë në posedim të paditësit Sh. L. , ne asnjëherë nuk e kemi ditur se këto prona janë në emër të paraardhësit tonë dhe jemi befasuar se si këto prona gjenden ne emrin tonë, pasi nuk jemi pronar të këtyre pronave dhe nuk e konsiderojmë veten pronar, edhe ne si të paditur kemi interes që këto parcela të barten në emër të paditësit pasi i njëjti i ka blerë shumë vite me parë, njëherit i propozojmë gjykatës që të merr aktgjykim në bazë të pohimit dhe pa mbajtje të seancës gjyqësore. Po ashtu kanë deklaruar me përgjegjësi penale dhe materiale se janë të vetmin trashëgimtar të të ndjerit S. L. dhe nuk ka trashëgimtar tjerë.

Gjykata, pas pohimit të kërkesëpadiisë nga ana e të paditurve, me anë të përgjigjes në padit vlerësoi se pohimi i të gjithë të paditurve është bërë me vullnet të lirë të pa penguar i nënshkruar nga palët e paditura veç e veç, njëherit konstatoi se kërkesa janë të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 148, paragrafit 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) – me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimin në bazë të*

*pohimit*)” – vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe po ashtu konform nenit 398 par.1 të LPK-së me të cilin përcaktohet se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*” (Aktgjykim pa seancë gjyqësore). Gjykata vendosi jashtë seancës lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Gjithashtu gjykata me rastin e vendosjes analizoi dhe shqyrtoi provat e bashkangjitura siç janë: certifikata e pronës në emër të S. L. me nr. Të lëndës ..., certifikata e vdekjes për S. L. , me nr. serik V ..., certifikata e vdekjes për M. L., me nr serik V ..., certifikata e vdekjes për I.L., me nr. Serik V ..., Ekstrakti për Sh. L. me nr. Serik E ..., ekstrakti për E. L. me nr. Serik E ..., Ekstrakti për R. L. me nr. Serik E ..., ekstrakti për I. L. me nr. Serik E ..., Ekstrakti për R. A. me nr. Serik E ..., Ekstrakti për B. L. me nr. Serik E ..., Ekstrakti për Sh. J. me nr. Serik E ..., Ekstrakti për L. L. me nr. Serik E ..., si dhe kopjen e dokumentit të identifikimit për paditësin Sh. L. .

Gjykata konstatoi se pala paditëse e ka paguar taksën për padi në lartësi prej 20€ e cila është në harmoni me vlerën e objektit të kontestit.

Nga sa u tha konform nenit 148 dhe nenit 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi

#### GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK

C.nr. 2023:239458 datë 27.08.2024.

Gjyqtari:

Burhan BERISHA

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimin pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.

Në kuptim të nenit 181 par. 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkakun se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.